



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 10.06.2024

Dokument parlamentar

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TE MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA) PËR VITIN 2023 DHE HARTIMI I DRAFTREZOLUTËS

- ***Hyrje***

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim Raportin vjetor të AMA-s për vitin 2023 në mbledhjet e tij të datave 27.05.2024 dhe 11.06.2024.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 27.05.2024 për të bërë prezantim e raportit vjetor, si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputeteve ishin Kryetarja e Bordit të AMA-s, znj.Armela Krasniqi, si dhe përfaqësues të tjerë të stafit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Komisioni caktoi relatores për këtë çështje deputetet, znj.Dasantila Tahiraj dhe znj.Merita Baku.

- ***Baza ligjore***

Bazuar në nenin 19, pika 14, dhe nenin 28 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë“ të ndryshuar”, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin vjetor të punës për vitin 2023.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi***

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën e paraqet në seancë plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2023, si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2024.

- ***Diskutimi në komision***

Në paraqitjen e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2023, Kryetarja e Bordit të AMA-s, znj. Armela Krasniqi, u ndal në disa nga çështjet e rëndësishme të aktivitetit të AMA-s. Ndër pikat kryesore që kanë të bëjnë me arritjet e AMA-s për vitin 2023, në të cilat u ndal znj. Krasniqi, ishin:

- Puna e bërë nga AMA për miratimin e Kodit të Ri të Transmetimit, i cili u miratua pas një procesi të gjatë këshillimi dhe diskutimi me të gjithë aktorët dhe reflekton në mënyrë të ekuilibruar pritshmëritë e të gjitha grupeve të interesit, evoluimin e kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar, si edhe rekomandimet e ekspertëve vendas dhe të huaj sipas standardeve dhe nevojave të tregut audioviziv shqiptar.
- Bashkëpunimi i AMA-s me institucionet e tjera në hartimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”; ligji i ri u miratua në Kuvend me 13 prill 2023 dhe bën të mundur përafrimin e pjesshëm me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 14 nëntor 2018, si dhe ndër të tjera edhe rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike.
- Puna e bërë nga AMA dhe roli ndërmjetësues i saj në lidhje me problemin e mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, përmes të cilit është bërë i mundur që edhe dy televizione të tjera kombëtare përveç RTSH-së, të nisin transmetimin e edicionit informativ të shoqëruar me interpreten e gjuhës së shenjave, duke përmbushur kështu të drejtën për informim të Personave me Aftësi të Kufizuar në Dëgjim.
- Puna e bërë nga AMA në inspektimin dhe monitorimin e subjekteve audiovizive në lidhje me cilësinë e sinjalit, si dhe kontentin e përmbajtjes së programeve.
- Organizimi i tryezave të diskutimit me operatorët audiovizivë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, për nxitjen e procesit të matjes së audiencës, si një instrument i rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri.
- Veprimtaria e Këshillit të Ankesave etj..

Pas znj.Krasniqi e mori fjalën znj. Dasantila Tahiraj, e cila në cilësinë e relatores u ndal në përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit, Kodin e Ri të Transmetimit, si dhe në disa nga arritjet dhe problematikat e AMA-s gjatë vitit 2023. Më tej, e morën fjalën deputetë të ndryshëm, përfaqësues të opozitës dhe maxhorancës parlamentare, të cilët i drejtuan disa pyetje znj.Krasniqi lidhur me aktivitetin e AMA-s gjatë vitit 2023, duke u fokusuar në disa çështje të rëndësishme, si: problemin e mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, përdorimin korrekt të gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive, mbrojtjen e fëmijëve, implementimin e strukturës së re të AMA-s, çështjet gjyqësore, etj.. Lidhur me këto pyetje, znj.Krasniqi, si dhe përfaqësues të tjerë të stafit të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhanë shpjegimet e nevojshme.

Komisioni shprehu, gjithashtu, angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me AMA-n, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale.

Ndërkohë, në mbledhjen e datës 11 qershor u diskutua dhe draftrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2023. Deputetët u njohën me draftrezolutën e përgatitur nga dy relatorët. Znj. Merita Bakiu, në cilësinë e relatores, lexoi të gjitha pikat e draftrezolutës të cilat ishin dakordësuar edhe me relatorin tjetër, znj. Dasantila Tahiraj. Në përfundim të mbledhjes, Komisioni me unanimitet miratoi në parim draftrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2023. Bashkëlidhur raportit të komisionit edhe draftrezoluta e miratuar.

Relatore

Dasantila Tahiraj

Merita Bakiu

**Zv.kryetare
Evis Kushi**

PROJEKTREZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar se ligji i ri nr.30/2023, datë 13 prill 2023 i miratuar në Kuvend për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, bën të mundur një përafrim të mëtejshëm me direktivën e BE-së, veçanërisht në drejtim të rritjes së transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, mbrojtjes së fëmijëve etj;

Duke theksuar rëndësinë e miratimit, gjatë vitit 2023, të Kodit të Ri të Transmetimit, si një akt shumë i rëndësishëm, i cili përcakton parimet, rregullat kërkesat dhe praktikatat e transmetimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë;

Duke theksuar nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive, përmes praktikave më të mira ndërkombëtare.

Vlerëson:

- Punën e bërë nga AMA për miratimin e Kodit të Ri të Transmetimit, i cili u miratua pas një procesi të gjatë këshillimi dhe diskutimi me të gjithë aktorët dhe reflekton në mënyrë të ekuilibruar pritshmëritë e të gjitha grupeve të interesit, evoluimin e kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar, si dhe rekomandimet e ekspertëve vendas dhe të huaj, sipas standardeve dhe nevojave të tregut audioviziv shqiptar.

- Punën e AMA-s si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin European (GNPIE).

- Punën e bërë nga AMA dhe rolin ndërmjetësues të saj në lidhje me problemin e mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, përmes të cilit është bërë i mundur që edhe dy televizione të tjera kombëtare përveç RTSH-së, të nisin transmetimin e edicionit informativ të shoqëruar me interpreten e gjuhës së shenjave, duke përmbushur kështu të drejtën për informim të Personave me Aftësi të Kufizuar në Dëgjim.

- Bashkëpunimin e AMA-s me institucionet e tjera në hartimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”; ligji i ri u miratua në Kuvend me 13 prill 2023 dhe bën të mundur përafrimin e pjesshëm me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 14 nëntor 2018, si dhe ndër të tjera edhe rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike.

- Bashkëpunimin e AMA-s me AKEP-in në inspektimet e kryera në lidhje me fenomenin e piraterisë, si dhe punën e bërë në lidhje me fenomenin tjetër që po haset në këtë periudhë, atë të

shtrimit të numrit të operatorëve piratë, që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive, pa autorizimin e AMA-s.

- Punën e bërë nga AMA në inspektimin dhe monitorimin e subjekteve audiovizive në lidhje me cilësinë e sinjalit, si dhe kontentin e përmbajtjes së programeve.

- Bashkëpunimin e AMA-s me rregullatorët e rajonit dhe të vendeve të BE-së, për çështje të rëndësishme të fushës së mediave audio dhe audiovizive me të cilat ato po përballen.

Rekomandon për vitin 2024

1. AMA të japë kontributin e saj në ndryshimet e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në përputhje me standardet dhe rekomandimet e BE-së, për adresimin e problematikave të rëndësishme që kanë të bëjnë me çështje, si: transparenca e financimit të mediave, përqendrimi i lartë i pronësisë së mediave, reklamat publike, rritja e pavarësisë së rregullatorit, etj..

2. AMA të luajë një rol proaktiv në organizimin e tryezave të diskutimit me operatorët audiovizivë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, për nxitjen e procesit të matjes së audiencës, si një instrument i rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri.

3. Të marrë masat e nevojshme për zbatimin e Kodit të Ri të Transmetimit nga ana e OSHMA-ve, veçanërisht lidhur me luftën ndaj diskriminimit dhe promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftën ndaj gjuhës së urrejtjes në transmetimet audiovizive, të cilat janë përfshirë për herë të parë në Kodin e Transmetimit.

4. Të monitorojë zbatimin nga ana e OSHMA-ve të Kodit të Ri të Transmetimit, veçanërisht pikat të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, që janë zgjeruar në Seksionin “Fëmijët në mediat audiovizive” dhe nënndarjet përkatëse.

5. AMA, pas përfundimit të kursit të formimit për 15 interpretë të tjerë me gjuhën e shenjave, të vazhdojë të ndjekë procesin e plotësimit me interpretë/përkthyes për transmetimin me gjuhën e shenjave, në mënyrë që ky detyrim ligjor për të drejtën për informim për Personat me Aftësi të Kufizuar në Dëgjim të përmbushet plotësisht.

6. AMA të vijojë të japë kontributin e saj si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për lirimimin e brezit digjital divident dy (DD2), si një proces me rëndësi dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

7. AMA të ketë në vëmendje rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe efektivitetit të rolit rregullator të saj, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore dhe sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit.

8. AMA të luajë një rol proaktiv, nga njëra anë, duke reaguar me vendosmëri në rastet e kanosjeve dhe sulmeve kundër gazetarëve dhe, nga ana tjetër, në përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të punësimit dhe sociale të tyre.

9. AMA të ketë në fokus të punës së saj nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare si dhe sigurimin e diversitetit në transmetimet audiovizive.

10. Të punojë për përmirësimin e kuadrit rregullator në drejtim të forcimit të luftës kundër piraterisë televizive, në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.